



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 314/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniai, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gazmend Zeqës nga koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër komisionerëve të vendvotimit 2201E/02R, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 314/2017 të datës 12.06.2017, të parashtruar nga Gazmend Zeqa koordinator i degës nga koalicionit PDK-AAK-NISMA-Shtime.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 12.06.2014, ka pranuar një ankesë Anr. 314/2017 nga Gazmend Zeqa koordinator i degës nga koalicionit PDK-AAK-NISMA-Shtime, në të cilën pretendohet se duke u bazuar në FRK-në e qendrës së votimit 2201E/02R, rezultoi se kandidati i këtij koalicioni me numër rendor 37 në kutin e votimit ka pasur 55 vota të konfirmuara nga komisioneri dhe vëzhguesi i tyre në këtë vendvotim, mirëpo gjatë plotësimit të FRK-së ka ardhur deri te gabimi teknik, ku 55 votat e numërit 37 janë bartur tek kandidati 36 i po të njejtë subjekt politik.

Parashtruesi i ankesave kërkon që të bëhet rinumërimi i këtyre kutive të votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes

së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 314/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.